

11/5/2026

**RAPORT PARAPRAK I
VLERËSIMIT TË NDIKIMIT
NË MJEDIS (Ligji nr.10.440,
shtojca II, Pika 10/b)**

***Objekti: Hartimi I Projektit
Dhe Preventivit Për
Ndërtimin E Spitalit Për
Persona Me Mjekim Te
Detyruar Me Vendim GjyKate
Në Ievp Shënkoll, Lezhe”me
Zhvillues Drejtoria e
Pergjitheshme e Burgjeve***

U HARTUA NGA SPECIALIST I LICENCUAR
ING. ERJONA QATIPi NR. CERTIFIKATE 5012
DT.04/07/2013 2026

PERMBAJTJA E RAPORTIT TE VNM-SE SE PARAPRAKE

- Përshkrim i legjislacionit në fuqi
- Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis duke përfshirë distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të
- Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes
- Informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e projektit dhe në afërsi të tij
- Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër si dhe në përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;
- Informacion për kohezgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara
- Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin
- Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

HYRJE

Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor identifikon, përshkruan dhe vlerëson efektet direkte të projektit tek njerezit, flora dhe fauna, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, klimën, terrenin dhe ndërtimi tij si dhe ndërveprimin e këtyre faktorëve me trashëgimime kulturore, sociale dhe mjedisore. Kjo temë është bazuar në parimet e veprimeve të parandalimit, dhe si e tillë politika më e mirë konsiston në mënjanimin e ndotjes dhe problemeve të tjera që janë ngritur.

Studimi i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e vendit të zhvillimit të aktivitetit duke përfshirë kushtet fizike atmosferike dhe të burimeve ujore dhe biologjike, burimet kulturore dhe gjendjen social-ekonomike të zones. Në procesin studimor të VNM përdoren informacioni dhe të dhënat ekzistuese dhe të perfituara rishtas mbi kushtet e vendit, së bashku me standardet dhe normat e zbatueshme për të vlerësuar impaktet potenciale mjedisore dhe sociale të fasiliteve të propozuara.

Ky raport hartohet mbi bazën e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim -marrese për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme.

VNM është një proces sistematik për të përcaktuar dhe vlerësuar efektet apo ndikimet në mjedis të një veprimi apo projekti të caktuar. Në një situatë normale, ky proces aplikohet përpara se të merren vendimet dhe të fillojnë angazhimet për realizimin e projektit. Por sidoqoftë, dhe në çdo kohë, efektet sociale, kulturore dhe shëndetësore janë konsideruar si pjesë integrale e VNM-së.

Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- ❖ Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- ❖ Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- ❖ Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- ❖ Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- ❖ Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- ❖ Parimi i qasjes së integruar
- ❖ Parimi i përgjegjësisë së ndërsjelle dhe bashkëpunimit
- ❖ Parimi "Ndotesi paguan"
- ❖ Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- ❖ Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit.

Në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për modernizimin dhe përafrimin e sistemit penitenciar shqiptar me standardet ndërkombëtare, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) ka ndërmarrë një nismë të rëndësishme reformuese për të transformuar Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP). Kjo Detyrë Projektimi i drejtohet projektimit të një Spitali Qendror Penitenciar të ri dhe modern, i cili do të shërbejë si qendra kryesore e referencës për kujdesin shëndetësor spitalor dhe specialist për të gjithë popullatën e burgjeve në vend, me një kapacitet të parashikuar shërbimi prej rreth 4000+ të dënuarve të të gjitha kategorive.

➤ INFORMACION PER QELLIMIN E VNM-se DHE METODIKEN E ZBATUAR

VNM gjithashtu përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet:

1. Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit që në fazën e përgatitjes së propozimeve në projekt.
2. Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit
3. Të japë një gjendje sa më reale nga pikëpamja e ndikimit dhe impaktit në mjedis nga aktiviteti që do zhvillohet.
4. Analizimin e faktorëve pozitivë dhe negativë mjedisorë, marrjen e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese për ndikimet negative.
5. Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimin cilësor të ndikimeve në mjedis të projektit.
6. Propozime dhe rekomandime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.

OBJEKTIVAT AFATSHKURTER TE VNM JANE

VNM gjithashtu përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet:

1. Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit që në fazën e përgatitjes së propozimeve në projekt.
2. Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit
3. Të japë një gjendje sa më reale nga pikëpamja e ndikimit dhe impaktit në mjedis nga aktiviteti që do zhvillohet.
4. Analizimin e faktorëve pozitivë dhe negativë mjedisorë, marrjen e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese për ndikimet negative.
5. Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimin cilësor të ndikimeve në mjedis të projektit.
6. Propozime dhe rekomandime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.

OBJEKTIVAT AFATSHKURTER TE VNM JANE

1. Përmirësim nga pikëpamja mjedisore të projektit të propozuar;
2. Të hartojë plane për menaxhimin e mjedisit dhe aksidenteve në vendin e punës;
3. Të hartojë planin për monitorimin e mjedisit për të mbajtur nën kontroll ndikimet;
4. Të informojë institucionet vendore, komunitetin dhe grupet e tjera të interesit për zhvillimin e projektit;
5. Të nxjerrë konkluzione dhe rekomandime mbi rëndësinë e projektit në lidhje me ndikimet negative dhe pozitive si dhe rëndësinë sociale të tij.
6. Objektivat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përfshijnë përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore gjatë zbatimit apo mos zbatimit të projektit.
7. Të minimizojë ndikimet e drejtpërdrejta në mjedis dhe në radhë të parë në elementet prioritarë si ruajtja e tokës, kontrolli i zhurmave, dhe ruajtja e cilësisë së ujit dhe ajrit.

8. Të ruajë ose rehabilitojë mjedisin natyror përmes elementeve të reja të ndërhyrjes pozitive, punimeve të veçanta në kuadër të projektit ose paralel me të, të cilët sigurojnë vijueshmërinë e qëndrueshme të mjedisit biologjik duke përfshirë faunën dhe florën në mjediset përreth zonës së marrë në konsideratë.
9. Të japë informacion mbi vendndodhjen e impiantit dhe të analizojë tiparet mjedisore
10. Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrë të duhur dhe me efikasitet;
11. Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit.
12. Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të disponueshme të teknologjisë së propozuar për tu aplikuar.

Objektivat afatgjatë të VNM janë:

- ❖ Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- ❖ Parashikon dhe parandalon ndryshimet/dëmtimet e pakthyeshme të mjedisit;
- ❖ Përmirëson aspektet sociale-ekonomike të projektit;
- ❖ Ndihmon në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;

Përshkrim i metodikës së zbatuar për hartimin e raportit të VNM-së.

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtme:

- ❖ Njohja dhe studimi i projektit, teknologjia e tij;
- ❖ Njohja me infrastrukturën ekzistuese të objektit ku kruhet aktiviteti;
- ❖ Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis;
- ❖ Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes;
- ❖ Historiku i ndërveprimit mjedisor;

PËRSHKRIM I LEGJISLACIONIT NË FUQI:

1. Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar;
2. Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar;
3. Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”;
4. Ligji nr. 10253, datë 11.03.2010 “Për gjuetinë”;
5. Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar;
6. Ligji nr. 9533, datë 15.05.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9385”;
7. Ligji nr. 9791, datë 23.07.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9385”;
8. Ligji nr. 15/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9385”;
9. Ligji nr. 36/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9385”;
10. Ligji nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar me ligjin nr. 38/2013;
11. Ligji nr. 68/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.07.2006 ‘Për mbrojtjen e biodiversitetit’”, i ndryshuar;

12. Ligji nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”;
13. Ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar me ligjin nr. 21/2024;
- 14. VKM nr. 686, datë 29.07.2015 “Për procedurën e VNM”, i ndryshuar me VKM nr. 204, datë 30.03.2026;**
15. VKM nr. 828, datë 28.12.2023 “Për procedurën e VNM dhe deklaratën mjedisore”;
16. VKM nr. 247, datë 30.04.2014 “Për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”;
17. Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar;
18. VKM nr. 575, datë 24.06.2015 “Për menaxhimin e mbetjeve inerte”, i ndryshuar;
19. VKM nr. 175, datë 19.01.2011 “Për strategjinë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve”;
20. VKM nr. 371, datë 11.06.2014 “Për mbetjet e rrezikshme”;
21. VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”;
22. VKM nr. 229, datë 23.04.2014 “Për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme”;
23. VKM nr. 519, datë 30.06.2010 “Parqet natyrore rajonale”;
24. Vendim nr. 22, datë 09.01.2008 “Për administrimin e pyllit komunal”;
25. Vendim nr. 1354, datë 10.10.2008 “Për fondin kullosor”;
26. Vendim nr. 396, datë 21.06.2006 “Për përdorimin e pyjeve nga njësitë vendore”;
27. VKM nr. 897, datë 21.02.2011 “Për zonat e veçanta të ruajtjes”;
28. VKM nr. 532, datë 05.10.2000 “Strategjia dhe plani i veprimit për biodiversitetin”;
29. VKM nr. 676, datë 20.12.2002 “Për monumentet e natyrës”;
30. VKM nr. 594, datë 10.09.2014 “Për cilësinë e ajrit”;
31. Vendim nr. 435, datë 12.09.2002 “Për normat e shkarkimeve në ajër”;
32. VKM nr. 352, datë 29.04.2015 “Për cilësinë e ajrit në mjedis”;
33. Udhëzimi i përbashkët nr. 2, datë 15.11.2023 “Për nivelin kufi të zhurmës në mjedis”.

KUADRI LIGJOR NDËRKOMBETAR

Raporti i VNM-se për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përqasë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat me kryesore:

- ✚ Direktiva e KE 1999/30/CE 22 Prill 199, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotoit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit.
- ✚ Direktiva 2000/60/CE e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës, Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave.
- ✚ Direktivës KE 42/2001 (të Këshillit të Evropës), mbi VNMS dhe VSM.
- ✚ Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës (21 Maj 2008) "Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën".
- ✚ Direktiva 75/442/CEE e Këshillit e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.
- ✚ Direktiva 91/689/CEE e Këshillit e datës 12 Dhjetor 1991, Mbi Mbetjet e Rrezikshme.
- ✚ Direktiva 2001/42/CE e Këshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave të Planeve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin.
- ✚ Direktiva 85/337/CEE e Këshillit e datës 27 Qershor 1985, Mbi Vlerësimin e Pasojave të Disa Projekteve Publike dhe Private mbi Mjedisin.
- ✚ Direktiva e Këshillit 96/62/EC Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.
- ✚ Direktiva 1999/30/CE, Në lidhje me vlerat kufi për NO₂, NO_x, SO₂, lëndët grimcore dhe Pbnë ajër.
- ✚ Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659 për cilësinë e ujrave të embla
- ✚ Direktiva 99/61/CE Për gropat e mbetjeve.

➤ PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti: *Hartimi I Projektit Dhe Preventivit Për Ndërtimin E Spitalit Për Persona Me Mjekim Te Detyruar Me Vendim Gjykatë Në Ievp Shënkoll, Lezhe*

Vendndodhja: Kompleksi ndodhet në territor periurban të Bashkisë Lezhë, në zonë me karakter bujqësor dhe me ndërhyrje institucionale të izoluara. Trualli ka sipërfaqe rreth 80,423 m², me gjurmë ekzistuese ndërtimi rreth 7,860 m².

PLANI I VENDOSJES



MASTERPLAN



VENDODHJA E OBJEKTIT




Tabela Nr. 1 Koordinatat e zones sipas sistemit GAUS GRUGER

Nr.	E	N
1	4388229.84	4617599.81
2	4388278.16	4617599.95
3	4388326.06	4617625.65
4	4388339.26	4617616.04

Tabela Nr.2. Kordinatat e zones sipas sistemit KRGJSH

Nr.	E	N
1	471359.13	4616652.55
2	471407.43	4616653.25
3	471455.03	4616679.50
4	471468.33	4616670.05

PLAN SISTEMIMI I OBJEKTIT



PLANET 3-DIMENSIONALE









Pershkrimi i objektit dhe i strukture

Kompleksi ndodhet në territor periurban të Bashkisë Lezhë, në zonë me karakter bujqësor dhe me ndërhyrje institucionale të izoluar. Trualli ka sipërfaqe rreth 80,423m², me gjurmë ekzistuese ndërtimi rreth 7,860m². Terreni është kryesisht i rrafshët, tipik për ultësirën aluviale, me prani të rrjeteve kulluese dhe tokave me nivel të lartë uji nëntokësor. I EVP Shënkoll shtrihet në një territor fushor të Bashkisë Lezhë, në afërsi të fshatit Shënkoll.

Konteksti territorial karakterizohet nga:

- terren i sheshtë dhe hapësira të mëdha të lira brenda rrethimit;
- kushte hidrologjike të ndjeshme (ujëra nëntokësore të cekëta/lagështi) dhe nevojë për vëmendje ndaj rreziqeve natyrore (sizmik, përmytje, klimatik), sipas analizave të riskut për Bashkinë Lezhë (dokumentacioni i riskut përfshin kapituj Ntë dedikuar për sizmicitetin, hidrogeologjinë dhe sistemin hidrik).

Godinat janë të adaptuara nga tipologji burgu. (me sakte nga shkolle riedukimi e vitete 80)

Organizimi është linear penitenciar. Mungojnë pavijone të strukturuar sipas profileve klinike.

Hapësirat terapeutike janë të kufizuara ose thuajse nuk ekzistojnë. Dhomat nuk janë projektuar fillimisht sipas standardeve psikiatrike bashkëkohore. Struktura ekzistuese nuk garanton ekuivalencë me standardet spitalore civile dhe nuk përmbush plotësisht kërkesat për trajtim terapeutik të integruar për pacientë me çrregullime të shëndetit mendor. I EVP Shënkoll Lezhë duhet të jete me shume spital me kushte sigurie se sa burg. Aktualisht e gjithë infrastruktura është jashtë kërkesave ligjore dhe standardeve që duhet të plotësojë ky institucion sipas ligjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar.

Kampusi ekzistues i I EVP Shënkoll përmban ndërtesa operative që duhet të vijojnë funksionimin edhe gjatë realizimit të investimit. Kjo e bën të domosdoshëm një masterplan që:

- minimizon ndërhyrjet në rrjetin e brendshëm të qarkullimit,
- shmang konfliktet mes kantierit dhe zonave operative, lejon fazim të punimeve pa bllokuar administrimin dhe trajtimin e pacientëve. Në këtë kuadër janë studiuar skema e gjendjes ekzistuese, plani i objekteve që do të shëmben dhe masterplani i propozuar (shih: figura përkatëse të masterplanit dhe skemës së lëvizjes).

Masterplani i ri vendos një bërthamë shëndetësore të organizuar në tri komponentë kryesorë, të integruar me logjikën e kampusit penitenciar:

(1) Godina e Spitalit (3K – Spital)

- Gjurmë: **1600 m²/kat** (rreth **64 m x 25 m**)
- Nivele: **4 kate** (nga -1 deri në +2)
- Sipërfaqe totale projektimi: **6400 m²**
- Shtesë teknike: **~220 m² zona e O₂** (stacion/zonë teknike e oksigjenit)

(2) Godina e Pavijonit (3K – Pavion)

- Gjurmë: **1200 m²** (rreth **64 m x 18.5 m**)
- Nivele: **3 kate**
- Sipërfaqe totale: **3600 m²**
- Tipologji dhomash për çdo kat: 10 dhoma katërshe + 4 dhoma teke (finale)

(3) Kuzhina/Objekti shërbimor (1K – Shërbime / Mensë / Kuzhinë)

- Gjurmë: **450 m²/kat** (rreth **18 m x 25 m**)
- Nivele: **2 kate** (-1 dhe 0)
- Sipërfaqe totale: **900 m²**
- Stacion GPL/gaz (brenda logjikës së shërbimit): **216 m²**

Këto volume janë pozicionuar në mënyrë që të krijojnë një kampus të lexueshëm dhe të kontrollueshëm, me akses të segmentuar dhe me mundësi fazimi, duke ruajtur ndërkohë hapësirat e domosdoshme të sigurisë, qarkullimit dhe ajrimit. Skema e lëvizjes e masterplanit parashikon: një qark të brendshëm të kontrolluar rreth bërthamës shëndetësore, hyrje/akses të diferencuar për funksione të ndryshme, mundësi për ndarje të flukseve (pacientë, staf, shërbime, emergjencë, vizitorë) pa mbivendosje. Kjo qasje ul konfliktet operacionale, thjeshton mbikëqyrjen dhe siguron funksionimin edhe gjatë ndërtimit në faza.

PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQES BIMORE KUPROPOZOHE TE NDERTOHE PROJEKTI DHE FOTOGRAFITE PERKATESE

Sipërfaqja ku propozohet ndërtimi i projektit "Ndërtimi i Spitalit për Persona me Mjekim të Detyruar në IEVP Shënkoll" ndodhet në një territor të ndikuar ndjeshëm nga faktori antropogjen (njerëzor). Mbulesa bimore përbëhet kryesisht nga formacione të vegjetacionit barishtor, me karakter ruderal dhe pionier. Flora Barishtore: Mbizotërojnë speciet barishtore spontane, të cilat janë përshtatur kushteve kopshtore të mjedisve institucionale dhe zonave rurale të Lezhës. Në përbërje të kësaj mbulese përfshihen familje si Poaceae, Asteraceae dhe Fabaceae. Vegjetacioni i Ulët (Shkurre): Vërehen disa fidanë ose ekzemplarë të shkëputur të shkurreve që hasen rëndom në zonën e Shënkollit (si murrizi, ferrat, etj.), të cilat nuk formojnë kurorë të mbyllur apo sipërfaqe pyjore të mirëfilltë.

Statusi Ekologjik: Nga vrojtimit paraprake, rezulton se në këtë sipërfaqe nuk ka prani të specieve të florës që bëjnë pjesë në "Librin e Kuq të Florës së Shqipërisë" apo që janë nën mbrojtje të veçantë sipas konventave ndërkombëtare. Mbulesa bimore ka vlerë mjedisore minimale dhe pas ndërtimit do të zëvendësohet me gjelbërim të sistemuar dekorativ.

Flora

Bimësia në sheshin e ndërtimit është kryesisht e tipit sekondar dhe spontan. Ajo klasifikohet në:

Bimësia Barishtore (Asociacionet Herbace): Mbizotërojnë speciet që rriten pas braktisjes së punimeve ose në mjedise të rrethuara, si: lofata, grami (Cynodon dactylon), jonxha e egër dhe lloje të ndryshme të familjes së çikoreve (Asteraceae). Kjo bimësi shërben kryesisht si mbrojtëse e sipërfaqes së dherave nga erozioni. Vegjetacioni Shkurror: Në kufijtë e rrethimit dhe në kanalet kulluese pranë zonës, hasen formacione shkurresh si ferra e zakonshme (Rubus ulmifolius), murrizi (Crataegus monogyna) dhe në disa raste kallami (Phragmites australis), i cili tregon praninë lartë të lagështisë në tokë (tipike për zonën e Shënkollit). Statusi: Nuk konstatohen specie të rralla, endemike apo në rrezik zhdukjeje. Flora ekzistuese ka një vlerë të ulët ekologjike dhe zëvendësimi i saj me një projekt gjelbërimi të sistemuar do të rriste vlerën estetike dhe mjedisore të zonës.

Fauna

Për shkak të pranisë së njeriut dhe rrethimeve fizike të IEVP-së, fauna është e kufizuar në specie të vogla që bashkëjetojnë me mjedisin e ndërtuar (Specie Antropogjene): Ornitofauna (Shpendët): Është grupi më i pranishëm. Përfshin shpendë si harabeli i shtëpisë (Passer domesticus), dallëndyshja, gugashja dhe sorra e hirtë. Gjatë periudhës së dimrit, për shkak të afërsisë me lagunën e Vainit, në qiellin mbi zonë mund të vërehen fluturime të shpendëve ujorë (rosat e egra apo krillat), por sheshi konkret i ndërtimit nuk përbën habitat folezimi apo ushqimi për ta. Herpetofauna (Zvarranikët): Në zonat me bar të lartë dhe në kanalet anësore hasen zvarranikë të vegjël si hardhuca e murit (Podarcis muralis) dhe në disa raste breshka e tokës (Testudo hermanni), e cila kërkon vëmendje për t'u zhvendosur manualisht nëse vërehet gjatë punimeve të gërmimit. Mamiferët e vegjël: Përfaqësohen kryesisht nga brejtësit e fushës, iriqi dhe herë pas here dhelpra, e cila mund të afrohet në kërkim të ushqimit në periferi të zonës së banuar.

FOTOGRAFITË E MBULESËS BIMORE EKZISTUESE NË SHËNKOLL, LEZHË




FOTOGRAFITË E MBULESËS BIMORE EKZISTUESE NË SHËNKOLL, LEZHË

PAMJE NGA ZONA E PROPOZUAR PËR NDËRTIMIN E SPITALIT

Zonat e mbrojtura

Sipërfaqja ku propozohet realizimi i projektit “Hartimi i Projektit dhe Preventivit për Ndërtimin e Spitalit për Persona me Mjekim të Detyruar me Vendim Gjykatë në Ievp Shënkoll, Lezhë **rezulton se nuk përfshihet brenda kufijve administrativë të asnjë zone të mbrojtur**, parku kombëtar apo rrjeti ekologjik të mbrojtur (siç është rrjeti Natura 2000 apo Emerlad). Trualli i parashikuar për ndërtim ndodhet në një zonë me destinacion institucional, e cila është transformuar prej kohësh nga ndërhyrjet antropogjene, duke paraqitur një distancë të sigurt gjeografike nga ekosistemet e ndjeshme të rrethit të Lezhës, siç është Rezervati Natyror i Menaxhuar “Kune-Vain-Tale”. Për rrjedhojë, ndërtimi i objektit të ri nuk parashikohet të ketë ndikime negative mbi habitatet natyrore, korridoret ekologjike apo speciet e mbrojtura të florës dhe faunës, pasi punimet do të kufizohen reptësisht brenda territorit ekzistues të Ievp Shënkoll, duke respektuar të gjitha normat mjedisore për mbrojtjen e ekosistemeve ligatinore që ndodhen në afërsi të rajonit.



a) Informacion per pranine e burimeve ujore ne sipërfaqen e zene nga projekti dhe ne afërsi te tij.

Brenda sipërfaqes së zënë nga projekti (në territorin e IEVP Shënkoll) nuk ekziston asnjë burim ujq natyror, si kroje, burime nëntokësore që dalin në sipërfaqe, lumenj apo liqene. Zona nuk përshkohet nga asnjë rrjedhë uji e përherëshme. Infrastruktura ujore e vetme në afërsi të truallit përbëhet nga kanalet kulluese artificiale, të cilat shërbejnë ekskluzivisht për largimin e ujërave të tepërta të reshjeve dhe drenazhimit të tokës, tipike për zonën fushore të Lezhës.



b) Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet ne biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër.

Raporti paraprak i vlerësimit të ndikimit në mjedis u hartua në përputhje me ligjin Nr.10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar.

Struktura e këtij raporti është hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi, në veçanti me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë dhe të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore”, i ndryshuar me **VKM nr. 204, datë 30.03.2026**. Ky raport hartohet mbi bazën e parimit të mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim-marrese për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme të cilat mund të kenë ndikim në mjedis. Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- ❖ Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- ❖ Parimi i zhvillimit të qëndrueshem
- ❖ Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- ❖ Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- ❖ Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- ❖ Parimi i qasjes së integruar
- ❖ Parimi i përgjegjësisë së ndërsjelle dhe bashkëpunimit

- ❖ Parimi "Ndotesi paguan"
- ❖ Parimi i drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- ❖ Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nënkupton mbrojtjen e integruar të perberësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh në fazën e planifikimit të zhvillimit të një territori të caktuar.

Mbrojtja e perberësve të mjedisit klasifikohet në:

- ❖ Mbrojtja e ajrit
- ❖ Mbrojtja e ujërave
- ❖ Mbrojtja e tokës
- ❖ Mbrojtja e natyrës
- ❖ Ndryshimet klimatike

Ky ndërtim do të kryhet mbi një sipërfaqe të lirë nga ndërtimet e cila nuk përdoret, nuk ka bimesë të lartë, nuk ka park natyror, nuk ka demtime të bimesës së zonës.

Bazuar në llojin e projektit të propozuar ndikimet më thelbësore mund të analizohen sipas dy fazave të veprimtarisë:

- ❖ Në fazën e ndërtimit.
- ❖ Në fazën e funksionimit.

Rëndësi ka të kuptohet natyra e këtyre proceseve dhe forma e shfaqjes së tyre, direkte apo indirekte, në mënyrë që të përcaktohet qartë lloji i ndikimeve.

Duke analizuar edhe shtrirjen në tokë të këtyre ndikimeve, ato klasifikohen në:

- ❖ Ndikime të kthyeshme në mjedis
- ❖ Ndikime të pakthyeshme në mjedis

Të dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së objektit të kërkuar dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizimin e proceseve të natyrës dhe rigjenerim të ekosistemit.

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtëm:

- ❖ Njohja me projektin dhe fazat e zbatimit të tij.
- ❖ Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis.
- ❖ Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes.
- ❖ Konsultimi me dokumenta ligjorë e administrativë dhe raporte të VNM-së për veprimtari të njëjta.
- ❖ Vlerësimi i rëndësisë së ndikimeve të identifikuar.

Ndikimet kryesore në mjedis nga ndërtimi dhe funksionimi i kësaj rruge konsistojnë në vijat e përgjithshme si më poshtë:

- ❖ Emetimet në ajër dhe zhurmat
- ❖ Shkarkimet në ujë
- ❖ Ndikimi në tokë
- ❖ Ndikimi në florë/faunë

- ❖ Mbetjet e prodhuara
- ❖ Ndikime social-ekonomike
- ❖ Ndikim në cilësinë e jetes në qendrat e banuara
- ❖ Ndikim në rritjen e trafikut rrugor
- ❖ Ndikim në peizazhin e zones
- ❖ Ndikim në ndryshimet klimatike

Ndikimet mjedisore e sociale të projektit janë konsideruar në dy fazat e tij; atë të ndërtimit dhe të funksionimit. Nëse faza e ndërtimit ka një qartësi kohezgjatjeje, ajo e operimit dhe/apo e mbylljes janë krejtësisht të varura nga mirëmbajtja e objekteve.

Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në biodiversitet

Zona ku do të zhvillohet ky projekt nuk bën pjesë në ndonjë kategori të zonave të mbrojtura dhe në afërsi të saj nuk ka zona me rëndësi kombëtare ose ndërkombëtare.

Referuar gjendjes aktuale të zonës, e cila është një zonë e zhveshur nga bimësia, gjatë fazës ndërtimore të projektit: Ndërtimi i "*Hartimi I Projektit Dhe Preventivitet Për Ndërtimin E Spitalit Për Persona Me Mjekim Te Detyruar Me Vendim Gjykatë Në Ievp Shënkoll, Lezhe*."

Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në ujë

Trupa ujqorë pranë zonës së ndërtimit të projektit në fjalë nuk ka, ato ndodhen në distancë të konsiderueshme. Shkarkime të mbetjeve të ndryshme në trupat ujqorë nuk do të ketë ndikimet negative që ndikojnë në cilësinë e ujqrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë nuk ka.

Gjatë fazës së ndërtimit nuk do të gjenerohen mbetje të lëngshme dhe si rrjedhojë ujqrat që mund të filtrojnë së bashku me ujqrat e rreshjeve të shiut nuk do të ndikojnë në ndotjen e ujqrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.

Mbetjet inerte që do të gjenerohen gjatë fazës së ndërtimit të objektit, do të menaxhohen nga kompania kontraktuese dhe nuk do të shkarkohen në asnjë trup ujqor. Derdhjet aksidentale të hidrokarbureve nga automejdet që do të përdoren gjatë fazës ndërtimore janë një nga burimet që ndikojnë në cilësinë e ujqrave sipërfaqësorë. Për shkak të largësisë me burimet hidrike është në qëndër të vëmendjes dhe nga ana e investitorit, i cili po investon në këtë projekt në mënyrë që të ketë kërkesa gjatë operimit dhe i intereson që cilësia e ujqrave të jete e pastër.

Bazuar në projektin teknik dhe në analizën e më sipërme, gjatë fazës ndërtimore të projektit nuk do të shkarkohen ndikime negative në cilësinë e ujqrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.

Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në tokë

Toka përbën një nga treguesit kryesorë të ndikimeve që mund të shfaqen gjatë fazës ndërtimore të projektit. Duke u bazuar në natyrën e punimeve dhe kohëzgjatjen e tyre, ndikimi në cilësinë e tokës parashikohet të jetë i kufizuar dhe i kontrollueshëm. Ndërtimi i objektit dhe krijimi i infrastrukturës ndihmëse do të realizohen sipas metodave standarde të ndërtimit, duke përdorur materiale të zakonshme dhe të certifikuar në tregun e ndërtimit. Nga analiza e projektit nuk rezulton përdorimi i materialeve të ndaluara apo i lëndëve të rrezikshme që mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e tokës. Gjatë punimeve do të realizohen gërmime për hapjen e themeleve, të cilat nuk priten të sjellin ndryshime të ndjeshme në morfologjinë e tokës, duke qenë se ndërhyrja është e kufizuar dhe e kontrolluar teknikisht. Po ashtu, duke marrë në konsideratë relievin fushor të zonës, nuk paraqiten kushte për procese të paqëndrueshmërisë së terrenit. Cilësia e tokës dhe karakteristikat e saj fizike nuk priten të ndikohen në mënyrë të ndjeshme, pasi nuk do të gjenerohen mbetje të rrezikshme dhe aktivitetet ndërtimore do të zhvillohen në kushte të kontrolluara. Ndikimet në tokë do të jenë minimale dhe të përkohshme, kryesisht të lidhura me fazën e ndërtimit. Sipërfaqja e ndërtimit përbën vetëm një pjesë të parcelës totale, ndërsa pjesa tjetër do të sistemohet dhe, aty ku është e mundur, do të rehabilitohet dhe gjelbërohet me bimësi të përshtatshme për zonën.

Bazuar në projektin teknik dhe në analizën e më sipërme, gjatë fazës ndërtimore të projektit do të shkaktohen ndikime negative në tokë të cilat vlerësohen të jenë të nivelit të vogël dhe të pa kthyeshme për arsye se sipërfaqja që do të zihet nga ndërtimi do të humbasë gjendjen natyrore të më parshme.

Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne ajer

Gjatë zhvillimit të punimeve ndërtimore për ndërtimin e projektit *Hartimi I Projektit Dhe Preventivit Për Ndërtimin E Spitalit Për Persona Me Mjekim Te Detyruar Me Vendim Gjykatë Në Ievp Shënkoll, Lezhe* me gjithë infrastrukturën e nevojshme do të shkaktohen ndikime të cilat do të ndikojnë në cilësinë e ajrit në këtë zonë. Ndikimet kryesore që do të shkaktohen janë:

- *Përhapja e grimcave të ngurta (pluhrave)*
- *Emetimi i gazeve*

Këto ndikime shkaktohen më shumë gjatë proceseve ndërtimore të gërmimeve dhe gjatë lëvizjes së automjeteve të transportit. Do të jenë fazat e para ndërtimore në të cilat do të identifikohen këto ndikime. Burimet e emetimit do të jenë të identifikueshme gjatë përgatitjes së sheshit të ndërtimit, dhe ndërtimit të kantierit të ndërtimit dhe gjatë transportit të mbetjeve inerte në këtë fazë. Emetimet në ajer mund të shkatoen nga emetimi i gazeve të motorëve me djegie të brendshme.

Punimet e gërmimit, janë një tjetër burim nga të cilët shkaktohen pluhura të cilët do të përhapen në ajër dhe do të ndikojnë në cilësinë e tij. Gjatë transportimit të inerteve dhe gjatë depozitimit të materialeve të nevojshme gjatë ndërtimit janë burime të tjera nga të cilat shkaktohen ndikime negative në ajër. Qarkullimi i automjeteve ose transporti materialit të gërmuar apo mbetjeve inerte të prodhuara janë gjithashtu burime të tjera emetimi të pluhurave në ajër.

Vlerësohet që këto ndikime në cilësinë e ajrit do të jenë të përkohshme dhe subjekti do të marrë të gjitha masat e nevojshme për minimizimin e tyre.

Ndikimet në ajër, të cilat do të jenë të ndjeshme në një rreze të shkurtër, dhe në varësi të kushteve meteorologjike, vlerësohen të jenë të nivelit të vogël, te përkohshme dhe të kthyeshme.

ç) Një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve.

Nje pershkrim i shkurter per shkarkimet e mundshme ne mjedis:

- 1.Shkarkimet ne mjedis nga zbatimi i ketij projekti, ne terma te shkurtuara do te ishte: Shkarkime ne ajer nga aktiviteti ndertimor. Pluhurat fluturues te kantierit te ndertimit, gazet e mjeteve te ndertimit dhe te transportit.
- 2.Shkarkime ne ujera nga ujerat e shiut nga kantieri dhe ujerat e zeza nga aktiviteti gjate shfrytezimit.
- 3.Shkarkimet e mbetjeve te ngurta, mbetjet urbane nga aktiviteti human dhe dheu qe do te largohet nga siperfaqja qe do te ndertohet.
4. Zhurmat e punimeve ndertimore, nga mjetet e renda, nga transporti, por edhe gjate funksionimit nga aktivitetet me muzike ne oret e vona, nese do te zhvillohen.

Emetimet ne ajer

Emetimet ne ajer vijne nga perhapja e pluhurave te materialeve te ndertimit dhe materialit te germuar te siperfaqes se tokes. Gjithashtu djegia e lendes djegese, qe shkaktohet nga automjetet qe frekuentojne kete ambjent, si dhe ne raste kur ka mungese te energjise elektrike dhe do te linde nevoja per ndezjen e gjeneratorit. Nga punimet ndertuese do te kete perhapje te pluhurave nga qarkullimi i mjeteve.

Perdorimi i reres, zhavorrit, proceset e betonimit dhe shtrimit te siperfaqeve perreth, si dhe nga transporti i automjeteve te dheut te germuar apo te mbetjeve inerte te prodhuara gjate ndertimit. Keto mjete duhet te plotesojne patjeter kushtet teknike te qarkullimit rrugor, te mos ngarkohen me shume se kapaciteti i projektuar,

